



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, 28 qershor), neni 17 i Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale (Ligji Nr.06/L-092 botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 03.04.2019), neni 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 25.06.2026 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni I

FORMOHET komisioni për vlerësimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale, me qëllim të zbatimit të procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale në përbërje prej:

1. Isljam Redzepllar- nga ekzekutivi;
2. Ukshin Berisha - nga ekzekutivi;
3. Marigona Berisha – Latifi - anëtare e Kuvendit të Komunës;
4. Granit Rifaj - anëtar i Kuvendit të Komunës;
5. Fejsal Shaqiri - përf. i sektorit joqeveritar “Sh.K.A. Bresana,

Neni II

1.1.Komisioni emërohet me qëllim të zbatimit të procedurës për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës:

1.2.Parcela Kadastrale P-70604014-00889-2 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Dragash , vendi i quajtur “Besëlidhja” me sipërfaqe 291 m2.

Neni III

Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, janë të përcaktuara me dispozita ligjore të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-10/2019”, komisioni ka autoritet, mandat dhe kompetencë të bëjë njoftimin publikë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, kushtet dhe kriteret specifik gjatë konkurrimit të hapur.

Neni IV

Kryetar i këtij komisioni është eksperti – i emëruari i parë ose eksperti të cilin e zgjedhin vetë anëtarët e këtij komisioni.

Neni V

Obligohet Administrata e Komunës që të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme me qëllim të efikasitetit të punës së Komisionit, për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, t’i zhvillojnë procedurat e konkurrimit të hapur, shprehjes së interesit dhe vlerësimin e ofertave.

Neni VI

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni VII

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024” dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

I dërgohet:

- MAPL-së (zyra ligjore) – Prishtinë;
- Komisionit për vlerësim, të gjithë anëtarëve;
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim;
- Arkivit;

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01Nr. 01/060/01-11872-4/26

Dt. 25.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Resul Fetahu

